



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:217127  
Datë: 18.06.2024  
Numri i dokumentit: 05831369

**PAKR.nr.215/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.N., nga Peja, për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 186 par.1 lidhur me par.5 dhe 3 të KPK, dhe të miturit A.N1., nga Peja, për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Pejë, përfaqësueses së autorizuar të palës së dëmtuar H.S., av.Aurora Mulhaxha, dhe mbrojtësit së të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.173/2022, të dt.23.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.14.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohen** si të pabazuara ankesat, e Prokurorisë Themelore në Pejë, përfaqësueses së autorizuar të palës së dëmtuar H.S., av.Aurora Mulhaxha, dhe mbrojtësit së të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.173/2022, të dt.23.02.2024, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.173/2022, të dt.23.02.2024, është shpallur fajtor i akuzuari A.N., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 186 par.1 lidhur me par.5 dhe 3 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në dënimin e shqiptuar me burgim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.26.04.2019, e gjerë në përfundim të dënimit të shqiptuar me burgim.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike, janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 200 Euro, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, shumën prej 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarit me aktvendim të veçantë iu është vazhduar paraburgimi gjerë në përfundim të dënimit, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me burgim.

II.Ndaj të miturit A.N1., në kuptim të nenit 68 par.2 të KDM dhe lidhur me nenin 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, është pushuar procedura penale për veprën penale pjesëmarrja në rrahje, nga neni 187par.1 të KPK, e udhëhequr sipas propozimit për shqiptimin e masës edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adaptues ose kujdestarit për të mitur, nga ana e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për të Mitur, pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer këtë veprë penale për të cilën është akuzuar.

E dëmtuara H.S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt civilo juridik.

Për këtë pikë të aktgjykimit, shpenzimet kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet në kuptim të nenit 403 të KPPK, ose që aktgjykimi të anulohet në kuptim të nenit 402 të KPPK, dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje,

- përfaqësuesja e autorizuar e palës së dëmtuar, av.Aurora Mulhaxha, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit A.N., ti shqiptohet dënim më i ashpër, në krahasim me dënimin e shqiptuar, si dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet dhe të refuzohet në tërësi akuza si e pabazuar, ose që i akuzuari të shpallet i pa fajshëm, për veprën për të cilën është akuzuar.

-Përgjigje në ankesë të prokurorisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, dhe ka propozuar që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.202/2024, të datës 05.04.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë si dhe përfaqësuesit të palës ë dëmtuar, ka propozuar që të njëjtat të aprovohen si të bazuara, që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit A.N., ti shqiptohet dënim më i ashpër, ose të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe çështja penale ti kthehet në rigjykim e vendosje.

Sa i përket ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar, e po ashtu edhe përgjigja në ankesë.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar dhe mbajtur seancën e kolegjit me dt.14.05.2024, dhe i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari A.N., i sjellë nga qendra e paraburgimit, përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar, djali A.N2., dhe mbrojtësi i të akuzuarit, av.Mustafë Kastrati.

Nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, e dëmtuara H.S., dhe përfaqësuesja e palës së dëmtuar, av.Aurora Mulhaxha, përkundër asaj që janë njoftuar me rregull, sikurse vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar – djali i të ndjerit M.N., A.N2., ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, si dhe përfaqësueses së autorizuar të palës së dëmtuar, dhe po ashtu ka propozuar që i akuzuari të dënohet sipas ligjit, pasi që i është bashkangjitur ndjekjes penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, ka deklaruar se mbetet pranë ankesës së ushtruar me shkrim, duke shtuar se përkundër faktit se kjo çështje penale është kthyer në rigjykim, gjykata e shkallës së parë, nuk i ka përfillur udhëzimet e Gjykatës së Apelit, duke mos e marrë për bazë ekspertizën e ekspertëve nga Republika e Shqipërisë, me të cilën është vërtetuar se i akuzuari nuk është kryes i veprës penale për të cilën është akuzuar. Duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana ka propozuar që i mbrojturi i tij, të lirohet nga akuza.

I akuzuari A.N., deklaroi se e mbështet ankesën e ushtruar, nga ana e mbrojtësit të tij, av.Mustafë Kastrati.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruar, nga ana e Prokurorisë Themelore në Pejë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, av.Aurora Mulhaxha, mbrojtësit së të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

**Ankesat, e Prokurorisë Themelore në Pejë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, av.Aurora Mulhaxha, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, nuk janë të bazuara**

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk janë përmbushur elementet inkriminuese të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 173 par.1 pika 1.3 të KPK, por të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1 lidhur me par.5 dhe 3 të KPK. Gjykata me aktgjykimin e ankimuar ka theksuar, se ka ekzistuar lëndimi i rëndë trupor, është vërtetuar nga mendimi i dhënë në ekspertizën e re mjeko ligjore, në të cilën eksperti Dr.Flamur Blakaj, ka përshkruar dëmtimet e jashtme trupore, të përshkruara dhe të konstatuara në raportin e autopsisë, për të cilat ekziston konstatimi se janë në formë hematome, gjak mbledhje nën lëkurore, gërvishtje dhe dërmishje të lokalizuara në kokë dhe trup, të përshkruara si dëmtime të jashtme një nga një dhe së bashku që të gjitha paraqesin lëndime të lehta trupore, por që pasoja e dëmtimeve të shkaktuara në kokë, ka qenë gjakderdhja subderale nën cipën e fortë trunore, e cila paraqet dëmtim të rëndë trupor. Që të gjitha këto janë përputhur me kohë e veprimin nga ana e të akuzuarit A.N., në dëm të të dëmtuarit, andaj si të tilla të përshkruara janë paraqitur edhe në ekspertizë. Se nga raporti i mjekësisë ligjore, përkatësisht edhe raporti i policisë, të njëjtat janë të përshkruara në mënyrë shumë të qartë, andaj gjykata e shkallës së parë është dashur që ti ketë parasysh që të gjitha këto prova materiale, e po ashtu edhe provat personale me qëllim që të njëjtat mos të bijën në kundërshtim njëra me tjetrën, dhe si rezultat i vlerësimit të të njëjtave, është dashur që kualifikimi juridik të qëndron si vrasje e rëndë, e jo sikurse është konstatuar në aktgjykim.

Po ashtu edhe nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale është rreshtuar në anën e prokurorisë, duke i cenuar të drejtat ligjore të akuzuarit për një gjykim të drejtë dhe të pa anshëm. Të gjitha provat të cilat janë proceduar dhe vlerësuar, nuk janë zbatuar përshtatshëmrisht me dispozitën ligjore nga neni 39 par.3 të KPPK, që nënkupton se e vënë në dyshim objektivitetin e trupit gjykues dhe se të njëjtat është dashur që të respektohen. Shkeljet e tjera esenciale janë manifestuar edhe nga neni 384 par.2, 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 7 të KPPK, për shkak se nuk janë vërtetuar me përkujdesjen e kërkuar ligjore dhe me vëmendje të gjitha faktet të cilat shkojnë në favore të të akuzuarit. Nuk janë zbatuar vendimet e Gjykatës së Apelit, me të cilat ka udhëzuar që për rekonstruim të vendit të ngjarjes, duhet të kryhet rekonstruimi si tërësi jo pjesërisht, që nënkupton se në këtë çështje penale nuk është mundur që të konstatohet se kur është gjetur viktima, sikurse theksohet pas 48 orëve, më konkretisht 2km, larg vendit të ngjarjes, për të vërtetuar të gjitha faktet të cilat ndërlidhen me këtë çështje penale. Të gjitha organet të cilat kanë zhvilluar procedurë në këtë çështje penale, sikurse janë policia, prokuroria, nuk kanë mundur që ta kalojnë atë teren, veçanërisht rrugën nga vendi i konfliktit deri te vendi ku është gjetur kufoma pas dy ditëve, në një distancë 2km, çka nënkupton se kurrësi nuk qëndron pretendimi i akuzës se viktima ka marr plagë vdekjeprurëse nga i akuzuari. Nga kjo rezulton se është shkelur neni 26 par.1 dhe 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane

për të drejtat e njeriut, se pse me refuzimin e rekonstruimit të vendit të ngjarjes, në tersi është shkelur e drejta për gjykim të drejt. Tjetër shkelje në aktgjykim ekziston edhe nga refuzimi i propozimit të mbrojtjes për kryerjen e ekspertizës së kardiologjisë, e cila është dashur që të kryhet pasi që viktima ka vuajtur nga një sërë sëmundjesh dhe ka mbetur e pa qartë se cili ka qenë ndikimi i shkakut të vdekjes. Kjo rezulton edhe nga ekspertiza e Dr.Musa Gashi, i cili ka konstatuar se infarkti i zemrës, nuk mund të paraqitet pa u mbyllur 70% e arteries, nuk ekziston shkencëtarisht, se të gjithë kardiologët dhe shkenca tregon se infarkti mund të paraqitet edhe me 30% të mbylljes së arteries koronare, të cilat sqarime edhe janë dhënë. Po ashtu edhe në pikën 7, të faqes së para fundit të ekspertizës nuk parashtrohet vdekja si pasojë e rrëzimit gjatë lëvizjes së tij. Që të gjitha këto të konstatuara nga ekspertiza e kryer, e cila është vëllimisht bukur e gjerë, ka kundërshtime në mes të të paraqiturave dhe provave të proceduara, andaj gjatë vlerësimit të njëjtit nuk japin mundësinë që aktgjykimi të mbështetet në faktet të cilat janë vërtetuar, ashtu që nga mendimi i IML lejohen dy mundësi të shkakut të vdekjes dhe me këtë drejtim në prezencën e këtij dyshimi për shkakun e vdekjes, pasi që nuk ka një vlerësim të drejtë atëherë vie në shprehje parimi “indubio pro reo”, që ndërlihet me të gjitha dyshimet e paraqitura dhe paqartësitë të cilat shfaqen, shkojnë në favor të të akuzuarit, i cili edhe është dashur që të lejohet nga fajësia.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sipas ankesës së prokurorisë dhe mbrojtësit të të akuzuarit, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara të parapara në nenin 384 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK.

Nga shkresat e lëndës si dhe vlerësimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, rezulton se dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe në harmoni me vetveten si dhe me pjesë të tjera të aktgjykimit, që rezulton se është i kuptueshëm, dhe i ndërtuar konformë dispozitave përkatëse ligjore pasi që janë vlerësuar të gjitha provat, të cilat janë në procedurë gjatë vlerësimit gjyqësor dhe pas vlerësimit të të njëjtave janë vërtetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale të lëndimit të rëndë trupor, nga neni 186 par.1 lidhur me par.5 dhe 3 të KPK, përkitazi me të akuzuarin A.N. dhe po ashtu gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur kur ndaj të miturit A.N1., për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPK, në kuptim të nenit 68 par.2 të KDM, lidhur me nenin 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, ka pushuar procedurën të ngritur sipas propozimit për shqiptimin e masës edukative, mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adaptues ose kujdestarit, sepse nuk është provuar se i mituri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata e shkallës së parë, pasi që ka vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, pasi që kjo çështje penale i është nënshtruar gjykimin, aktvendimi me shenjë PAKR.341/2022, të dt.09.09.2022, duke i dhënë udhëzime që në këtë çështje penal të bëhet këqyrja e vendit të ngjarjes për të vërtetuar momentin e marrjes së plagëve të dëmtuarit, tërheqjen e tij, gjerë në stanin e vet, i cili ka qenë në largësi prej 2km, si dhe situatën e ndodhur pasi që këtu i akuzuari së bashku me djalin e tij, kanë shkuar në stan, të të dëmtuarit dhe e kanë gjetur të njëjtin në gjendje të rëndë. Që të gjitha veprimet e ndërmarra është me rëndësi që duhet të korrespondojnë në mes veti, përndryshe gjykata e shkallës së parë nuk do të mund të kryente ndonjë veprim i cili është kompatibil me

kryerjen e veprës penale. Nga deklarata e të akuzuarit në mënyrë të qarë është përshkruar mënyra e kryerjes së veprës penale, e cila edhe është vërtetuar pas rekonstruimit të vendit të ngjarjes, momenti i kryerjes së veprës penale, ku i akuzuari ka marrë lëndime trupor, të cilat janë të përshkruara në raportin e IML, e po ashtu ehe në ekspertizën e kryer gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, andaj, që të gjitha ato lëndime të cilat janë pësuar fillimisht rezultojnë se i akuzuari A.N., ia ka shkaktuar të dëmtuarit në ditën kur ka filluar, situata e krijuar pikërisht me dt.26.04.2019, rreth orës 18:00, e më pastaj pasi që është larguar i akuzuari nga vendi i ngjarjes dhe ka shkuar në stanin e vet, ka filluar përlëshja fizike prapë derisa i dëmtuari nga lëndimet trupore të marra, është gjetur i vdekur. Kjo vërtetohet nga të gjitha provat personale sikurse janë deklarata e këtu të akuzuarit A.N., deklarata e të miturit A.N1., deklarata e dëshmitarit Sh.L., deklarata e dëshmitarit E.R., si dhe nga të gjitha provat materiale që shikuar si tërësi në mënyrë të qartë dhe saktë japin përshkrimin e kryerjes së veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Po ashtu kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse i njëjti ka përmbushur anën formalo juridike, nga neni 369 par.7 të KPPK, sepse janë dhënë arsye të qarta dhe të plota për secilën pikë të aktgjykimit, e pasi që të gjitha janë vlerësuar si tërësi është ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 186 par.1 lidhur me par.5 dhe 3 të KPK, dhe që në mënyrë të qartë dhe të drejtë në kuptim të nenit 68 par.2 të KDM, lidhur me nenin 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, pasi që nuk ka provuar se në veprimet e të miturit A.N1., janë formuluar elementet e veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje, nga neni 187 par.1 të KPK, ka pushuar procedurën për të mitur.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykim të gabueshëm, sepse ri cilësimi i veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 pika 1.3 të KPK, në veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.1 lidhur me par.5 pika 3 të KPK, duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 15 vite, jemi të mendimit se gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim të gabuar, duke ra në kundërshtim me parimin e gjetjes së vërtetës materiale në procedurën penale dhe me detyrimin e saj që të vlerësoj provat në mënyrë të drejtë, veç e veç, dhe që të gjitha së bashku do të kenë ndikim sa më të drejtë në vërtetimin e veprës penale për të cilën është akuzuar. Sipas pretendimeve ankimore ri cilësimi i veprës penale, duke konstatuar se kjo çështje penale është kryer me dashje të plotë dhe se kanë ekzistuar elementet që në të njëjtën ka pasur dijeni dhe dashje për tu kryer e njëjta, dhe nisur nga këto rrethana, ekziston mendimi se vepra penale e kryer është si rezultat i veprimeve të akuzuarit, në drejtim të të dëmtuarit, dhe se i akuzuari A.N., ka qenë i vetëdijshëm se fillimisht e ka goditur të dëmtuarin 7-8 herë me bisht të sëpatës në kokë, në duar dhe në këmbë, afër stanit të viktimës, e më pas ka vazhduar duke e ndjekur viktimën nga pas dhe duke vazhduar edhe brenda në stan, e më pas ka vazhduar dhe ka sulmuar, duke goditur prapë të cilat lëndime janë të përshkruara në raportin e autopsisë me nr.MA19-114, të vërtetuara edhe në ekspertizën mjeko ligjore, konzuliare të dt.15.11.2023, dhe si pasojë e largimit nga vendi i ngjarjes së bashku me të miturin A.N1., nuk i kanë ofruar ndihmë me çrast është shkaktuar pasoja që

rezulton me vdekjen e tani të ndjerit M.N.. Që të gjitha këto dëmtime të marrura, i dëmtuari nga ana e të akuzuarit, janë përshkruar në mënyrë të qartë dhe të plotë, duke rezultuar se të njëjtët janë marrë në duar, këmbë dhe në gjithë trupin, e po ashtu edhe goditur në kokë, nga të cilat goditje është shkaktuar traumë në tru dhe shqyerje e enëve të gjakut, duke rezultuar në gjakderdhje subderale, masive, e cila në këtë rast ka qenë shkaktar i vdekjes. Që të gjitha këto lëndime të pësuar, rezulton si me pasoja për të dëmtuarin, që nënkupton se rezultojnë me kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, e jo sikurse është ricilësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Po ashtu edhe në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, ndaj të miturit A.N1., për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPK, gjykata e shkallës së parë, e ka pushuar procedurën me arsyetimin se nuk ka mundur që të vërtetojë që në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë tiparet e veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje, andaj mendojmë se nuk është nxjerrë vendim i drejtë, sepse që të dy babë e bir, kanë filluar ta godasin të dëmtuarin me grushta, kurse babai i të miturit A1., A.N., e ka goditur me bisht të sëpatës pasi që ka arritur që t'ia tërheq nga dora dhe menjëherë nga goditjet të cilat ia ka dhënë atëherë e ka rrezuar për tokë, ndërsa i njëjti ka theksuar se unë e kam penguar babain që mos ta godas axhën, të gjitha veprimet i ka ndërmarrë me qëllim që të mos vjen deri te eskalimi i situatës. Në deklaratë thekson se axha e ka marrë një shishe plastike me ulje të zezë, dhe na ka stërpikë me te, dhe krejt rrobat i kemi pasur të zhytura. Pasi që na ka stërpik axha, babai e ka goditur shtatë deri tetë herë me sëpatë trupit, këmbëve dhe duarve, sa e kam parë unë, e më pastaj e kam kap babain dhe e kam larguar, kurse axha ka shkuar në qoshin e asaj dhome të stanit, ku ka ndodhur rrahja dhe është ulur si gjysmë i shtrirë. Ja kemi dëgjuar disa gjëmime dhe fjalë duke i thanë babait “të vraftë Zoti”. Po ashtu gjykata e shkallës së parë përkundër asaj që ka vërtetuar se viktima M.N., ka qenë i rrahur nga ana e A.N.t, e po ashtu edhe nga i mituri A.N1., është vërtetuar edhe nga transkripti i bisedës së zhvilluar në mes të viktimës M.N., nga telefoni me nr.049-922-248, duke filluar nga ora 18:05minuta, kur është informuar policia se i akuzuari A.N., me të miturin A.N1., janë duke prerë dru në malin e fshatit R.....e A....., ashtu që të gjitha veprimet të cilat janë ndërmarrë në drejtim të të dëmtuarit, vërtetojnë se në veprimet e të njëjtit është kryer vepra penale për të cilën i njëjti është akuzuar.

Edhe mbrojtësi i të akuzuarit av.Mustafë Kastarati, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se në këtë çështje penale janë vërtetuar faktet kryesore siç janë lidhja kauzale mes veprimit dhe pasojës, plaga vdekje prurese, vendi i marrjes së saj, koha e marrjes së plagës dhe paraqitjes së vdekjes, lidhja e sëmundjeve të viktimës me pasojën, e veçanërisht çka e ka shkaktuar plagën vdekjeprurëse. Që të gjitha provat nuk janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe qartë nga ekspertiza e IML, andaj gjykata e shkallës së parë, pasi që ka qenë në situatë të atillë, duke i shndërruar aludimet në provë dhe duke mos ditur as rrugën se nga ka shkuar viktima nga vendi i përleshjes deri te vendi ku është gjetur viktima, atëherë edhe aktgjykimin e merr jo të drejtë. Po qesë të kishte vlerësuar në mënyrë më përmbajtjesore të gjitha provat, atëherë me siguri që mbështetjet e nenit 12 të KPK, do të vinte në përfundim se vepra penale është kryer në mbrojtje të nevojshme, apo po qesë të vlerësohej neni 13 i KPK, do të vinte në shprehje se në rastin konkret i akuzuari ka vepruar në nevojë ekstreme, duke mos pasur qëllim që të kryej veprën penale për të cilën është akuzuar. Që të gjitha provat nga shkresat e lëndës nuk argumentojnë se vepra penale është kryer me paramendim, dashje apo qëllim, por ka pasur karakter të zbrapsjes së sulmit nga

vetja dhe nga djali i mitur, për të mos u goditur nga i dëmtuari me sëpatë. Në rastin konkret mbrojtja ka qenë që ta shmang sulmin e provokuar dhe mos të ketë pasoja në drejtim të tyre, ashtu që është zbatuar dispozitat ligjore nga neni 341 lidhur me nenin 7 dhe 327 par.1 pika 1.4 të KPPK, ngase parimi i barazisë së armëve dhe palëve në procedurë, ja lenë mundësinë që të gjitha palëve që të zbatojnë ligjin dhe të nxjerrin vendim sa më të drejtë në vendin e ngjarjes. Gjykata ka vetëm deklaratën e të akuzuarit dhe të birit të tij, duke mos pasur asnjë dëshmitar tjetër okular, andaj është dashur që të vërtetohet që vepra penale është kryer nga kryesi, se viktima ka qenë kryesi duke rezultuar me veprën e kryer që ndërlihet me viktimën. Në këtë drejtim jemi të mendimit që gjykata e shkallës së parë është dashur të ketë parasysh se veprimet e të akuzuarit a janë juridikisht të lejueshme, apo të pa lejueshme provokuese dhe nxitëse, apo kauzale dhe racionale, e mandej të vie në përfundim se në këtë veprim të kundërligjshëm nga ana e të akuzuarit janë plotësuar tri elemente të sulmit, nga tani i ndjeri ndaj të akuzuarit, sikurse është shqetësimi dhe sulmi pa shkas, goditja me sëpatë ndaj të akuzuarit dhe të birit si nxitës, dhe konstrukti i fuqishëm fizik, i viktimës dhe personaliteti i tij konfliktuoz, andaj me vlerësimin e këtyre tipareve jemi të mendimit se këtu i akuzuari nuk e ka dëshiruar as sulmin e as pasojën, dhe se në veprimet e tij, nuk ka pasur dëshirë apo qëllim që ta privoj nga jeta, këtu të dëmtuarin, që nënkupton se vepra penale për të cilën është akuzuar, nuk qëndron si e tillë dhe ka propozuar që pasi që nuk është provuar se e njëjta është kryer nga ana e të akuzuarit A.N., propozon që i njëjti të lirohet nga akuza, në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sipas ankesës së prokurorisë, si dhe ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë pasi që ka proceduar dhe vlerësuar që të gjitha provat, po ashtu ato materiale dhe personale, ka bërë ri cilësimin juridik të veprës penale, nga vrasje rëndë nga neni 173 par.3 në veprën penale lëndimi i rëndë trupor, në nenin 186 par.1 lidhur me par.5 dhe 3 të KPK, kurse sa i përket të miturit A.N1., për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje, nga neni 187 par.1 të KPK, ka pushuar procedurën në kuptim të nenit 68 par.2 të KDM, lidhur me nenin 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në ankesën e prokurorisë, nuk është arritur që të argumentohet pretendimi ankimor, pasi që gjykata e shkallës së parë, në mënyrë shumë të qartë ka dhënë arsyetim për secilën pikë të aktgjyimit, që ngjarja e cilat është objekt i akuzës ka ndodhur me dt.26.04.2019, rreth orës 18:00, në vendin e quajtur P.....mbi Q..... e B....., në afërsi të R..... së A....., Komuna e Pejës, duke i shkakuar lëndime të rënda trupore, dhe atë me bisht të sëpatës vëlluat të tij M.N., si rezultat i raporteve jo të mira mes vete për një kontest pronësor juridik, lidhje me pronën e malit. Ditën kritike i akuzuari A., së bashku me të miturin A.N. shkojnë në bjeshkë për të marr trupa, pasi që i marrin i ngarkojnë duke u nisur në drejtim të stanit për të marrë gjysmën tjetër të ngarkesës në ndërkohë ka dalë viktima i cili kishte lajmëruar paraprakisht policinë për prerje të trupave, ju del përpara të akuzuarit A. dhe të mituri Atdhetar, me çrast viktima e sulmon me sëpatë të akuzuarin, mirëpo i njëjti në përleshje e sipër arrin që t'ia hjek sëpatën nga duart, pasi që fillimisht janë përleshur, dhe atëherë e godet me të njëjtën. E ka goditur shtatë deri tetë herë me bisht të sëpatës dhe në pjesë të ndryshme të trupit, duar këmbë, e më pastaj largohet nga vendi i



ngjarjes duke lënë viktimën në gjendje të rëndë shëndetësore, i cili kishte pësuar dëmtime në pjesë të ndryshme të trupit të konstatuara në raportin e autopsisë dhe ekspertin mjeko ligjore të dt.15.03.2023, e plotësuar nga eksperti Flamur Blakaj me dt.19.04.2024, që së bashku këto dëmtime paraqesin dëmtime të lehta trupore, por pasoja e dëmtimeve të shkaktuara në kokë, ka qenë gjakderdhja subderale në cipën e fortë trunore e cila paraqet dëmtim të rëndë trupor, e në rastin konkret me pasojë vdekjeprurëse. Që të gjitha këto veprime të ndërmarra nga ana e të akuzuarit A.N., vërtetohet edhe në bazë të deklaratës së vet të akuzuarit, i cili përshkruan se ditën kritike pasi që kanë shkuar në bjeshkë për të prerë trupa, ka ardhur deri te konflikti me këtu të dëmtuarin M.N., dhe si rezultat i përleshjes tani i ndjeri me sëpatë e ka sulmuar të akuzuarin, mirëpo i njëjti ka arritur që t'ia nxjerrë bishtin e sëpatës nga duart dhe ndërkohë me të njëjtën e ka goditur fillimisht në vend të ngjarjes, pastaj e ka ndjekur mbrapa edhe në stan, pasi që kanë shkuar së bashku me djalin A.N1., atëherë i dëmtuari iu ka qitë vaj të zezë (ule), duke i lagur në teshat që i kanë pasur në trup, e më pastaj i akuzuari A., prapë e ka goditur në pjesë të ndryshme të trupit, nga të cilat goditje i dëmtuari pas dy dite ka nderuar jetë. Këto vërtetohen edhe në bazë të deklaratave të dëshmitarëve Sh.L. e E.R., të dhëna në shqyrtimin gjyqësor të dt.03.04.2023, dëshmitarit A.N., në shqyrtimin gjyqësor të dt.07.04.2023, e pastaj edhe deklaratës së dëshmitares H.S.. Po që të gjitha këto prova materiale, kanë dakortësi edhe me provat materiale, sikurse janë raporti i policisë, vërtetimi mbi sekuestrimin e pronës, lëshuar në emër të Sh.L., fotografitë e vendit të ngjarjes, procesverbali i vendit të ngjarjes, raportet policore lidhur me raportimin e viktimës në polici, për prerjen e trupave nga i akuzuari dhe i mituri, raportet e policisë, transkriptet e bisedave, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, raporti i bastisjes, fotografitë e vendit të ngjarjes, anketa sociale për të miturin A.N1., raporti para ndëshkues nga SHSK, raporti i autopsisë së viktimës M.N., me nr.MA19-114, i pranuar me d.t04.07.2019, raporti i plotësimit të autopsisë, mendimi i ekspertëve mjekoligjor Dr.Arben Lloja dhe Dr.Elmaz Shaqiri, nga Tirana, i dt.30.05.2021, si dhe prova të tjera nga shkresat e lëndës, kanë lidhje koherente, që nënkupton se pa shkëputeshmërinë e provave personale me ato materiale, vërtetojnë në mënyrë të padyshimtë se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të qarë janë vlerësuar të gjitha elementet e veprës penale, dhe është ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale lëndim i rë3ndë trupor nga neni 186 par.1lidhur me par.5 dhe 3 të KPK.

Përkundër asaj që mbrojtësi i të akuzuarit mundohet që në këtë çështje penale të fut institutin e mbrojtjes së nevojshme dhe të nevojës ekstreme në kryerjen e kësaj veprë penale, duke pretenduar si në dispozitën ligjore mbrojtja e nevojshme është mbrojtje e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm real dhe të atë çastshëm ndaj vetes ose personit tjetër, e kushte që karakteri mbrojtës të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi, apo të nevojës ekstreme duke ardhur në përfundim se përsosni vepron në nevojë ekstreme, me qëllim për të zbrapsur prej vetes ose tjetrit rrezikun e atëçastshëm e të pa provuar, i akuzuar nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër me kushte që e keqja e shkaktuar mos të jetë më e madhe se e keqja e kanosur, kolegji vie në përfundim se asnjëherë në këto institute nuk e përcjellin kryerjen e veprës penale e lëndimit të rëndë trupor, sepse i akuzuari të gjitha veprimet të cilat i ka ndërmarrë i ka marrë me dashje dhe me qëllim që ti shkaktoj dëmtime trupore të dëmtuarit.

Kjo vërtetohet edhe në bazë të provave të cilat ndërlidhjet me faktin se i akuzuari ka pasur për qëllim të dëmtuarit ta dëmtoj e jo ta vras, sikurse pretendohet në aktakuzë, e pasi që janë

vërtetuar elementet qenësore të veprës penale të lëndimit të rëndë trupor, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vlerësuar kur e ka bërë ri cilësimin juridik të veprës penale, në veprën penale sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga të gjitha vlerësimet të cilat i ka bërë kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Po ashtu, në këtë çështje penale të vendosur nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nga ana e të njëjtës janë respektuar edhe dispozitat nga Kushtetua e Republikës së Kosovës, sikurse është nenin 26 par.1 dhe neni 31, sepse gjykata e shkallës së parë është përkujdesur që të zhvilloj gjykim të drejtë dhe të mbështetur në prova, andaj në këtë drejtim ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, nuk ka bazë për shqyrtim të mëtejme.

Sa i përket shkeljeve të ligjit penal, ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit av.Mustafë Kastrati, duke theksuar se në këtë çështje penale përfshihet me shkelje të ligjit penal, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 186 par.1 lidhur me par.5 dhe 3 të KPK, sepse gjykata e shkallës së parë, të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale të theksuar më lartë, dhe ne mendojmë që në këtë çështje penale ka pasur më shumë hapësirë ligjore që të vlerësohet që në veprimet e të akuzuarit a ka tejkalim të mbrojtjes së nevojshme dhe janë vërtetuar rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, sepse është vërtetuar lidhja kauzale në mes të veprimit apo mos veprimit të akuzuarit dhe pasojës. Pasi që këto çështje nuk janë vërtetuar në masë të duhur, atëherë aktgjykimi i nxjerr nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se nuk janë vlerësuar të gjitha provat në kuptim të nenit 7 të KPPK, sepse prokuroria dhe gjykata kanë qenë të detyruara që saktësisht të vërtetojnë faktet dhe provat se i akuzuari ka kryer me dashje dhe paramendim lëndimin me pasojë vdekjeje, pa afruar prova të duhura të cilat vërtetojnë kryerjen e veprës penale, për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës sipas ankesës së ushtruar, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, sikurse pretendohet në ankesë, ngase gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të qartë dhe të drejtë ka vlerësuar se shkeljet e ligjit penal në kuptim të nenit 385 të KPPK, nuk qëndrojnë pasi që gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në këtë çështje penale janë formuluar elementet qenësore të veprës penale të lëndimit të rëndë trupor, nga neni 186 par.1 lidhur me par.5 dhe 3 të KPK, si dhe ndaj të miturit A.N1., elementet e veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPK.

Sa i përket të akuzuarit A.N., gjykata ka vendosur drejt kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale, sepse nuk ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale si dhe nga ndjekja penale se lidhur me veprën penale është zbatuar ligji i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale se me marrjen e vendimit, ka vepruar gjykata në bazë të kompetencës ligjore, duke respektuar të gjitha dispozitat ligjore.

Sa i përket të miturit A.N1., gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur ka pushuar procedurën penale ndaj të njëjtit, sepse ka gjetur rrethana për pushimin e së njëjtës, dhe se ka ardhur në përfundim se i mituri duhet përjashtuar nga përgjegjësia dhe ndjekja penale e të njëjtit, dhe se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore.

Përfaqësuesja ligjore e palës së dëmtuar, av.Aurora Mulhaxha, ka ushtruar ankesë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë është dashur që të përkujdeset që të vlerësoj në mënyrë më përmbajtësore të gjitha rrethanat me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, e sidomos është dashur të vlerësoj mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, se nga ky rast është vrarë një person, kurse me vendimin për dënimin të marrë në kohëzgjatje prej 15 viteve, pasi që është bërë ri cilësimi juridik, jemi te mendimit se nuk pritet që të arrihet efekti dhe qëllim i tij, sepse në këtë vepër penale ka ekzistuar dashja në kryerjen e së njëjtës.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av.Mustafë Kastrati, ankesë ka ushtruar lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar se në këtë çështje penalo juridike, gjykata e shkallës së parë është dashur që të vlerësoj se nga ana e të akuzuarit nuk është kryer vepra penale për të cilën është shpallur fajtor dhe se dënimi i shqiptuar është tepër i lartë, sepse nuk ekziston dashja në kryerjen e së njëjtës, andaj jemi të mendimit që me një dënim sa më të butë, sikurse që është të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe i akuzuari të shpallet i pa fajshëm, me këtë lloj vendimi do të arrihej efekti dhe qëllimi i tij, i paraparë më ligj.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e përfaqësueses së autorizuar të palës së dëmtuar, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati, e po ashtu edhe ankesës së prokurorisë, përkundër asaj që sipas së njëjtës nuk është ankimuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, për këtë bazë ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila rezulton pasi që janë vlerësuar të gjitha provat, sikurse personale dhe ato materiale, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPK, dhe si rrethanë rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarit A.N., si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, se nuk i ka ofruar asnjë lloj ndihme, pas kryerjes së të njëjtës, ndërsa si rrethanë lehtësuese nuk ka pasur, andaj i ka shqiptuar dënim sikurse në diapozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket vlerësimit të situatës, përkitazi me të miturin, gjykata ka vlerësuar se në veprimet e të njëjtit nuk janë vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale, të pjesëmarrjes në rrahje nga neni 187 par.1 të KPK, andaj edhe ka nxjerrë aktgjykim lirues në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar ankesën e përfaqësueses së autorizuar të palës së dëmtuar, nga e cila nuk gjeti ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, sikurse nuk gjeti ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit A.N., av.Mustafë Kastrati,

dhe ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit A.N., do të arrihet efekti dhe qëllimi i tyre, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK.

Vendimi për pushimin e procedurës penale ndaj të miturit A.N1., është marrë në kuptim të nenit 68 par.2 të KDM, lidhur me nenin 363 par.1 pika 1.3 të KPPK.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.215/2024, të datës 14.05.2024**

**Procesmbajtës,  
Endrit Ajeti**

**Anëtarët e kolegjit,  
Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit,  
Ferit Osmani**

**Zyhdi Haziri**